



INSTITUCIONET E PERKOSSHME VETEQEVERISESE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVES – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCES DHE TEKNOLOGJISE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

UDHËIMI ADMINISTRATIV

LËNDA; VAZHDIMI I KONTRATAVE TË PUNËSUARVE
NUMËR; MASHT[I] 17/2002
DATË; 17 tetor. 2002.

Në bazë të Rregullores nr. 2001/19 të dates 4 tetor 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve Kalimtare të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Ministria e Arsimit, Shkences dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtij Udhëzimi është që të vazhdohen kontratat e këtyre punëtorve:

- a. Drejtoret e shkollave
- b. Arsimitaret e kualifikuar
- c. Arsimitaret e pakualifikuar

Neni 2.

Vazhdimi i kontratave të punës së Drejtorve të shkollave

2.1. Me këtë Udhëzim Administrativ MASHT-I vazhdon kontrata e tashme të punësimit për Drejtor të shkollave për vitin shkollor 2002/2003 deri me datën 31.12.2002 në tërë territorin e Kosovës, varësisht nga kushtet e përcaktuara në nenin 6. më poshtë.

2.2 Kontratat e vazhduara do të aplikohen nga 1 shtatori 2002 deri më 31 dhjetor 2002

Neni 3

Vazhdimi i kontratave të punës së arsimtarve të kualifikuar

3.1. Me këtë Udhëzim Administrativ MASHT-i vazhdon kontratat e tanishme të punësimit me të gjithë arsimtarët e kualifikuar deri më 31 gusht 2003, varësisht nga kushtet e përcaktuara në nenin 6. më poshtë.

Neni 4.

Vazhdimi i Kontratave të arsimtarëve të planifikuar

4.1.Me këtë Udhëzim Administrativ MASHT-i vazhdojn kontratat e tashme të punësimit për arsimëtar të pakualifikuar, deri më 31 gusht 2003.varësisht nga kushtet e përcaktuara në nenin 6 më poshtë.

Neni 5.

Nënshkrimi i kontratës

5.1.Puntorëve të cilëve i është vazhduar kontrata e punësimit në bazë të nenit 2. 3 dhe 4 të lartëshënuar nuk kan nevoj të nënshkruaj dokumentin për vazhdimin e kontratës së punësimit të tij/saj.Kontrata është vazhduar në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 6

Përfundimet

6.1.Vazhdimi I kontratave të punësimit që kanë të bëjnë me nenin 2,3 dhe 4 të lartëshënuar, si dhe kontratave tjera të punësimit të cilat kanë filluar në vitin shkollor 2002/03, varet nga kushtet vijuse

- a. moshë 65 vjeçare, asnjë punonjës I cili ka mbushur këtë moshë në fillim të vitit shkollor 2002/03 nuk mund të vazhdoj kontratën e punësimit me MASHT-in .
- b. nëse ka qenë i larguar për shkak të masave disiplinore .
- c. ka shkëputur kontratën për ndonjë arsye tjetër më pare.

Neni 7.

Kushtet e Kontratës

7.1.Kushtet e kontratës të parapara në kontratat e të punësuarve mbesin të njëjta përveç dates së origjinalit, e cila me këtë Udhëzim është vazhduar.

Neni 8.

Hyrja në fuqi

8.1.Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi më 18.10.2002.,.

Mr.Rexhep Osmani, Ministër
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë